

AKT- THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Shopin'Club Europe SHPK

Në Durrës, sot më datë 14 / 04 / 2023, ortaku I vetëm themelues i shoqërisë

Shopin'Club Europe SHPK:

Z. CRISTIANO CARRERA, atësia Sergio, i datëlindjes 06.12.1967 , lindur në Itali, Genova dhe banues në Formigine, shtetas Italian, madhor, dhe me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaportë me numër YA7183313.

Me cilësinë e "ortakut themelues" kërkoj redaktimin e këtij akti themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroi se me vullnet të lirë të plotë e të sinqertë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, **Shopin' Club Europe shpk**

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shopin'Club Europe shpk

Është, person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj Shoqëria **Shopin'Club Europe shpk**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga shtetasi Italian **Z. Cristiano Carrera**, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në: Tiranë, Zk. 8330, Nr. I pasurisë 6/271+2-30, apartamenti nr. 52, SH/K 2, Sip.57.6 m². Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

Neni 4

Objekti i veprimtarisë



Konsulencë, asistencë dhe shërbime në lidhje me fushën e projekteve, krijimeve, përpunimi i të dhënave, zhvillimit, menaxhimit, mirëmbajtjes, blerja, shitja, kontraktim i jashtëm ose delegimi i platformave informatike/teknologjike, sistemeve të ndërfaqes, sistemeve informatike, software; Krijimi dhe menaxhimi i faqeve dhe portaleve të internetit që përfshin: konsulencë, asistencë, prezantim shërbimesh, zhvillimi i analizave socio-informatike, studime dhe kërkime drejtuar shoqërive ose në favor të tyre në fushën e menaxhimit dhe trajtimit të rrjeteve të shijes.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar I Shoqërisë është në vlerën 100 000 (njëqind mijë) Lekë. Kontributi I ortakut përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
2. Pjesëmarrja e ortakut në Shoqëri është në raport me kontributet e tij, dhe vlera nominale e kuotave të tij, e cila llogaritet në raport me këtë kontribut, është paraqitur në mënyrë të përmblendhur në tabelën e mëposhtme:

<u>NR.</u>	<u>Emri I Ortakut</u>	<u>Kuota</u>	<u>Vlera</u>	<u>Përqindja</u>
<u>1</u>	<u>Cristiano Carrera</u>	<u>1</u>	<u>100 000 Lekë</u>	<u>100%</u>
	<u>TOTALI</u>	<u>1</u>	<u>100 000 Lekë</u>	<u>100</u>

3. Kapitali mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakeve sipas normave të fushës në fuqi.
4. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqesohen nga letra me vlerë të tregëtueshme.
5. Kontributi I ortakut mund të jete ne para ose ne natyre, pasuri e luajtshme/e paluajtshme apo te drejta.
6. Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
7. Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Ortaku i vetëm i shoqërisë është organi vendimmarrës i shoqërisë. Ortaku i vetëm i shoqërisë është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë. Ortaku vendos për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i drejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim , përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë caktohet **Z. CRISTIANO CARRERA**, atësia Sergio, i datëlindjes 06.12.1967 , lindur në Itali, Genova dhe banues në Formigine, shtetas Italian, madhor, dhe me zotësi juridike për të vepruar, i cili emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë përtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm themelues të Shoqërisë .

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumenta përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raportoi përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e Asamblesë në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratorët, së bashku edhe veças njëri-tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtzakonshëm. Administratorët e përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizik e juridik, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet në 31 dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të ortakëve themelues
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit

d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”

e) me vendim të Gjykatës

Në këtë rast Asambleja merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Neni 13

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjiit “Për tregtarët dhe Shoqërit tregtare”, Kodit Civil dhe cfarë do ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi u redaktua në 4 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues I shoqërisë tregtare, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale .

ORTAKU I VETËM THEMELUES I SHOQËRISË

CRISTIANO CARRERA

CRISTIANO CARRERA

